

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Vula e jashtme **nuk ka mbërritur ende**, pra deri këtu verifikimi kalon nga ne.

ARTIKULLI

TITULLI	Rama “lan duart” me Vlora Hysenin: Nuk bëjmë avokatinë e askujt, lirohet nga detyra
ADRESA	https://boldnews.al/2026/09/22/rama-lan-duart-me-vlora-hysenin-nuk-bejme-avokatine-e-askujt-likohet-nga-detyra/
BURIMI	boldnews.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	23 shtator 2026, 04:59:40 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	22 shtator 2026, 13:39:09 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	60267f63a2f3da61e74ede6e9a4bb84ac4e4084505d78c6df8a9b6c884a2bfff7
TEKSTI	7c34b9ca36bd11b57f685647507fa97a006e112ea22283d7de06fe0b88421a44
PAMJA	f191e15a7d5b3b4741d0b35c8b173bb6b1ef88a6d7f3713ff10a3338c5511926

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	c05b355018c9133b49225ee1387304b06467118b868bbfe6e231f4e90f0f2642
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	4a111ad93b0774e4315d3f6f441e1591ae8aff5c47e01d9c0b726a490b4da86a
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR ZINXHIRIN E PROVËS

Vula e jashtme nuk ka mbërritur ende për këtë hyrje. Kodi të nxjerr te faqja jonë e provës, e cila është e jona — pra deri këtu integriteti provohet, koha jo.

Kur vula të regjistrohet te doc.al, kjo dëshmi riprodhohet dhe kodi çon jashtë nesh. Adresa e jashtme shkruhet vetëm kur ajo ekziston vërtet.

<https://factcheck.al/prova/c05b355018c9133b49225ee1387304b06467118b868bbfe6e231f4e90f0f2642>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Fillimi > AKTUALITET

Rama "lan duart" me Vlora Hysenin: Nuk bëjmë avokatinë e askujt, lirohet nga detyra

15:39 : 22/09/2026 në AKTUALITET, POLITIKE



Kryeministri Edi Rama ka reaguar pas vendimit për caktimin e masës së sigurisë "arrest në shtëpi" ndaj drejtoreshës së Shërbimit Informativ të Shtetit, Vlora Hyseni.

Nga Nju Jorku, Rama tha se është informuar për masën e kërkuar nga SPAK dhe se pret që çdo dyshim ndaj drejtueses së SHISH të hetohet dhe të zbardhet deri në fund përmes procesit gjyqësor.

Në të njëjtën kohë, Rama njoftoi se Vlora Hyseni do të largohet menjëherë nga drejtimi i Shërbimit Informativ të Shtetit.

Sipas tij, vendimi formal do të merret sapo të rikthehet në Tiranë.

Reagimi i Ramës:

Lexo edhe:

[Lala zbardh dosjen e Vlora Hysenit: Informacionet sekrete që i jepte Ergys Agasit](#)

[Arrestimi i Vlora Hysenit/ Shkullaku: Shteti kontrollon nga krimi i organizuar](#)

Për shkak të orareve të ndryshme ky reagim nga Nju Jorku, ku jam për Asamblenë e Përgjithshme të OKB-së, mund të duket i vonuar dhe ndjesë për këtë. Jam informuar lidhur me masën e arrestit shtëpiak që SPAK-u ka nxjerrë për drejtoren e Shërbimit Informativ të Shtetit, e pres që çdo dyshim i organit të akuzës të hetohet dhe zbardhet deri në fund përmes procesit të pavarur gjyqësor.

Përtej respektit për punën dhe për personin e Vlora Hysenit, si edhe po ashtu përtej vlerësimeve të vazhdueshme, që ajo ka marrë nga agjencitë partnere si drejtuese e shërbimit inteligjent shqiptar, rruga pa kthim që kemi zgjedhur është rruga e pavarësisë së organeve të drejtësisë për të hetuar e gjykuar këdoqoftë, pavarësisht statusit social apo funksionit publik.

TË GJITHA



Horoskopi, 23 shtator/ Zbuloni çfarë parashikojnë yjet për secilën shenjë

22:58 : 22/09/2026



Lala zbardh dosjen e Vlora Hysenit: Informacionet sekrete që i jepte Ergys Agasit

22:57 : 22/09/2026



Arrestimi i Vlora Hysenit/ Shkullaku: Shteti kontrollon nga krimi i organizuar

22:43 : 22/09/2026



Kosova nuk ka linja fluturimi me Azerbaixhanin! Misteri i udhëtimit të Vlora Hysenit

22:42 : 22/09/2026



Maqedonia e Veriut arreston ish-luftëtarin e UÇK-së

22:33 : 22/09/2026



Turisti i huaj 'tallet' me shqiptarët që shohin shtrembër

22:25 : 22/09/2026



Flakët jashtë kontrollit në Lalz, rrezikohen banesat

22:11 : 22/09/2026

Por po ashtu, është e pashmangshme mesa duket, që çdo hetim apo masë e marrë nga drejtësia në adresë të personave publikë, të kthehet në një motivim për të grirë mish njeriu në mexhelisin politik e mediatic dhe për të thirrur “litarin” si në sheshet e ekzekutimit mesjetar, kohë përpara sesa gjykata të thotë fjalën e saj. E megjithatë, kurrësesi nuk mund të jetë e vërtetë që veprimet e pavarura të drejtësisë dhe afirmimi i vijueshëm i barazisë para ligjit, të jenë njëkohësisht akt-akuza kundër pikërisht një shumice qeverisëse e cila me kurajo e me vendosmëri, ia ka çelur rrugën drejtësisë së pavarur, në një vend ku deri para shumë pak vitesh kjo pavarësi ishte e paimagjinueshme prej shekujsh.

As mund të jenë këto zhvillime me drejtësinë baltë kundër Shqipërisë, e cila po bën në rrugën e saj të bashkimit me Europën shumëçka që as nuk mund të imagjinohet akoma në vendet e tjera të rajonit dhe që koha do ta çmojë më mirë se sa kushdo.

Çdokush është i pafajshëm deri në gjykimin përfundimtar po askush nuk është mbi ligjin në asnjë rast e për asnjë arsye, kështu që unë i jam falenderues Vlora Hysenit për çdo gjë që ka bërë si duhet në shërbim të Shqipërisë, ndërsa për gjithçka tjetër që ka të bëjë me çështjen e sapohapur nga organet e drejtësisë, qëndrimi im mbetet po ai i ditës së parë të Reformës në Drejtësi: Pafajësia ose fajësia e një bashkëpunëtori të vendosur nën akuzë është një çështje individuale përballë prokurorisë e gjykatës dhe kjo shumicë qeverisëse me mua në krye, i mbetet besnike këtij qëndrimi duke mos hyrë në meritën e asnjë çështjeje të drejtësisë dhe duke mos bërë avokatinë e askujt që përballet me drejtësinë. Lirimi nga detyra i drejtores së shërbimit është i menjëhershëm, e sapo të kthehem në Tiranë dhe në konsultim me Presidentin e Republikës, do të zgjedhim drejtuesin e ri të Shërbimit Informativ të Shtetit.

Etiketa: Edi Rama vlora hyseni

Lajme të lidhura



Lala zbardh dosjen e Vlora Hysenit: Informacionet sekrete që i jepte Ergys Agasi

22:57 : 22/09/2026



Arrestimi i Vlora Hysenit/ Shkullaku: Shteti kontrollohet nga krimi i organizuar

22:43 : 22/09/2026



Kosova nuk ka linja fluturimi me Azerbaixhanin! Misteri i udhëtimit të Vlora Hysenit

22:42 : 22/09/2026



Gazetarja zbulon detaje nga dosja e Hysenit: Dyshohet për komunikime me Agasin kur ishte në kërkim

22:05 : 22/09/2026



Bushati: Ja si e krijoi Rama më herët alibinë për arrestimin e Vlora Hysenit

21:30 : 22/09/2026



Begaj dekreton shkarkimin e Vlora Hysenit nga drejtimi i SHISH

21:19 : 22/09/2026



RRETH NESH

Boldnews.al mbetet zgjedhja e parë për një lexues i cili kërkon të informohet me saktësi për një lajm. Misioni jonë kryesor është paanshëmëria dhe profesionalizmi dhe për këtë janë të punësuar gazetarët më të mirë në tregun mediatic.
Na kontakto:

NA NDIQ

